Prishtinë, më 21 shtator 2012

R A P O R T

Ankesa nr. 442/2011
M. B.

Kundër

Gjykatës Komunale në Gjilan,
Qendrës për Punë Sociale në Gjilan

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 24.10.2011, ka pranuar ankesën e znj. M. B., kundër Gjykatës Komunale në Gjilan dhe Qendrës për Punë Sociale në Gjilan, për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve përkatëse ligjore, lidhur me rastin e dhunës në familje dhe besimit të fëmijës.

Procedura në Institucionin e Avokatit të Popullit

Më 24 tetor 2011, znj. M. B. (në tekstin e mëtejshëm ankuesja) ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër Gjykatës Komunale në Gjilan dhe Qendrës për Punë Sociale në Gjilan, për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve përkatëse ligjore lidhur me rastin e dhunës në familje dhe besimit të fëmijës.

Më 25 tetor 2011, me qëllim të hetimit të rastit, dy përfaqësuese të IAP-së kanë vizituar Gjykatën Komunale në Gjilan dhe janë takuar me administratorin e gjykatës, me ç'rast kanë kërkuar kopjen e dosjes së rastit të ankueses, e cila i është dorëzuar IAP-së më 27 tetor 2011.

Më 25 nëntor 2011, po ashtu, dy përfaqësuese të IAP-së kanë vizituar Qendrën për Punë Sociale në Gjilan (QPS), duke kërkuar qasje në dokumente zyrtare, konkretisht kopjen e dosjes së rastit të ankueses. Zyrtarët e QPS-së fillimisht kanë refuzuar dorëzimin e kopjes, sepse sipas tyre dorëzimi i saj është në kundërshtim me ruajtjen e konfidencialitetit të rastit. Por, pas diskutimit dhe shpjegimit të mandatit të IAP-së, të përcaktuar në Ligjin për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, zyrtarët e QPS-së janë pajtuar që IAP-së t'i kopjohet dosja e rastit dhe t'i dorëzohet më 28 tetor 2011.

Më 1 nëntor 2011, përfaqësueset e IAP-së kanë vizituar QPS-në në Gjilan, për ta marrë kopjen e premtuar të dosjes, por edhe kësaj radhe zyrtarët e këtij institucioni nuk ua kanë dhënë dosjen e lëndës.

Më 3 nëntor 2011, në takim me zyrtarët e QPS-së në Gjilan ata ua lejuan përfaqësueseve të IAP-së vetëm marrjen e shënimeve nga dosja, por jo edhe kopjen fizike të saj. Në pamundësi të sigurimit të kopjes, ato kanë përshkruar një pjesë të të dhënave të rastit nga lënda dhe kërkuan vazhdimin e punës më 4 nëntor 2011.

Më 4 nëntor 2011, shefi i shërbimeve sociale të QPS-së në Gjilan njoftoi se nuk mund të takohej me përfaqësueset e IAP-së, pa dhënë ndonjë shpjegim.

Më 21 nëntor 2011, Avokati i Popullit i dërgoi një letër ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale për ta informuar për veprimet e zyrtarëve të QPS-së, lidhur me pengimin e punës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit.

Më 30 nëntor 2011, Avokati i Popullit mori një përgjigje nga drejtori i QPS-së në Gjilan, nga e cila njoftohet se QPS ka shprehur gatishmëri për bashkëpunim me IAP-në, si dhe gatishmërinë për t'i dorëzuar kopjet e lëndës.

Më 1 dhjetor 2011 drejtori i QPS-së në Gjilan dorëzoi kopjen e lëndës së ankueses.

Në dhjetor 2011, përfaqësues të IAP-së, me qëllim të marrjes së informatave shtesë për rastin, kanë kontaktuar me një zyrtare të lartë të Policisë të Kosovës.

Rrethanat e rastit në Policinë e Kosovës dhe në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe faktet në bazë të informatave që IAP ka në dispozicion, mund të përmblidhen si në vijim:

Përkitazi me dhunën në familje

Më 26 prill 2005, në Stacionin Policor të Gjilanit, ankuesja nga Prishtina paraqiti rastin e dhunës në familje kundër vjehrrit të saj, M. H. Rasti në Stacionin Policor është regjistruar me referencë 2005-CA-0708.

Më 12 maj 2005, Policia e Kosovës e dërgoi rastin në Prokurorinë Publike Komunale në Gjilan.

Më 12 maj 2005, prokurori i Prokurorisë Komunale lëshoi një urdhër për të kërkuar nga një ekspert i mjekësisë ligjore të bëjë ekzaminim fizik të lëndimeve të ankueses (PP nr. 698/2005).

Më 16 maj 2005, nga Spitali Rajonal në Gjilan, eksperti mjekësor ka lëshuar certifikatë mjekësore, me të cilën është konstatuar se viktima, përkatësisht ankuesja, kishte pësuar lëndime të lehta trupore.

Më 24 maj 2005, Prokuroria Publike Komunale e Gjilanit ka ngritur propozimakuzë kundër M.H. për veprën penale lëndim i lehtë trupor, sipas nenit 153, paragrafi 4 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

Më 31 mars 2009, Gjykata Komunale në Gjilan mori vendimin P. Nr . 605/05, me të cilin pushohet procedura penale kundër të pandehurit, përkatësisht vjehrrit të ankueses, *për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.*

Më 17 prill 2009, ankuesja ka parashtruar një ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, kundër vendimit të lartpërmendur, përmes Gjykatës Komunale në Gjilan.

Më 14 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan ka marrë një aktvendim, me të cilin refuzohet ankesa e ankueses si e pabazë.

Përkitazi me kontestin gjyqësor për besimin e fëmijës në ruajtje, kujdes dhe edukim

Më 26 gusht 2010, ish-bashkëshorti i ankueses A.H. ka parashtruar padi kundër nënës së tij S.H., e cila me Aktvendimin nr. 05-2056/09, të datës 18 shkurt 2010, të QPS në Gjilan, ishte caktuar si kujdestare e fëmijës së tij A.A.

Më 5 tetor 2010, Gjykata Komunale në Gjilan ka marrë një Aktvendim me të cilin ka kërkuar që e paditura S.H., në afat prej 15 ditësh, të paraqesë përgjigjen në padi (të paraqesë prapësimet procedurale dhe deklaratën se a e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit).

Më 11 tetor 2010, e paditura S.H, ka dorëzuar në Gjykatën Komunale një përgjigje në padi, me të cilën nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit që atij t'i besohet fëmija A.A. në ruajtje, kujdes dhe edukim.

Më 25 tetor 2010, Gjykata Komunale në Gjilan, në seancën gjyqësore, me Aktgjykimin C. nr. 437/2010, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.H. dhe ka vendosur që fëmija A.A., e bija e ankueses dhe e paditësit, t`i besohet në ruajtje dhe edukim babait të saj.

Në këtë seancë gjyqësore *nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i QPS-së dhe në shkresat e lëndës nuk është gjetur thirrja prej gjykatës për QPS-në në Gjilan.*

Përkitazi me procedurën e Qendrës për Punë Sociale në Gjilan për caktimin e kujdestarisë për fëmijën A.A.

Më 27 prill 2005, QPS Gjilan e referoi rastin e dhunës në familje, të paraqitur nga ankuesja, në Policinë e Kosovës (në atë kohë SHPK). Policia, po atë ditë e ka intervistuar ankuesen, e cila ishte viktimë e dhunës në familje dhe i ka ofruar shërbimin mjekësor, pa praninë e përfaqësuesit të QPS-së. Pas pranimit të ndihmës mjekësore, ankuesja kishte vendosur të kthehej në shtëpinë e prindërve të saj në fshatin Shkabaj.

Më 3 qershor 2005, QPS ka pasur takim me ankuesen, ku ishte i pranishëm edhe babai i saj. Në raportin kronologjik të aktiviteteve të kësaj date, të prezantuar nga QPS në Gjilan (raporti nuk është i nënshkruar) është shënuar deklarata e ankueses se ajo nuk dëshiron të kthehet në familjen e bashkëshortit dhe nuk ka mundësi që ta marrë fëmijën në ruajtje dhe edukim, sepse është e re dhe planifikon të martohet.

Më 15 qershor 2005, nën përcjelljen e zyrtarit të QPS-së, është realizuar kontakti i parë në mes të ankueses dhe fëmijës së saj A.A.

Më 12 korrik 2005, ankuesja kishte parashtruar një kërkesë të re në QPS në Gjilan, për vënien e kontaktit me fëmijën A.A.

Më 21 korrik 2005, përmes QPS-së në Gjilan, realizohet kontakti i ankueses me fëmijën.

Më 16 nëntor 2006, QPS viziton familjen e ish-bashkëshortit të ankueses. Si arsye e vizitës ishte mosbashkëpunimi i familjes në fjalë me QPS-Gjilan, sa i përket sigurimit të dokumenteve për regjistrimin e fëmijës në librin amë të të lindurve, e për këtë regjistrim, si kusht i domosdoshëm ishte kopja e letërnjoftimit të dy prindërve të fëmijës.

Më 20 nëntor 2006, me rastin e kontaktit të zyrtarit përgjegjës të QPS-së me ankuesen, ajo informoi se fëmija tashmë ishte regjistruar në librin amë të të lindurve.

Më tej, në të njëjtën ditë, para zyrtarit përgjegjës ankuesja kishte deklaruar se tani e tutje ishte e interesuar që kontaktin me fëmijën ta realizonte sipas një aktvendimi të QPS-së e jo sipas marrëveshjes me familjen e ish-bashkëshortit. Për këtë kërkesë të saj, ankuesja është këshilluar nga QPS që t'i parashtrojë dokumentet e nevojshme, si kopjen e letërnjoftimit të saj dhe kopjen e certifikatës së fëmijës të posaregjistruar.

Në periudhën kohore 2007 dhe 2008, ankuesja nuk është lajmëruar në QPS në Gjilan.

Më 9 mars 2009, ankuesja parashtroi një kërkesë në QPS në Gjilan për besimin e fëmijës A. A.

Më 25 maj 2009, QPS ka marrë një aktvendim me të cilin S.H., përkatësisht vjehrra e ankueses. caktohet si kujdestare e përkohshme për fëmijën A.A.

Më 25 tetor 2010, QPS vendosi mbi pushimin e kujdestarisë së përkohshme ndaj fëmijës, pasi Gjykata Komunale në Gjilan me Aktgjykimin C. nr. 437/10 kishte vendosur për bashkimin familjar të fëmijës me prindin biologjik, respektivisht me babain, i cili më pas, pa autorizimin e ankueses-nënës së fëmijës, e kishte marrë fëmijën për të jetuar me të në Zvicër.

Më 20 korrik 2011, ankuesja për realizimin e kontaktit me fëmijën është paraqitur në QPS në Gjilan, ku njoftohet se kërkesën duhet ta parashtrojë në QPS në Novobërdë, pasi si rezultat i decentralizimit territorial, për çështjen e ankueses kompetente ishte QPS në Novobërdë.

Baza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mes tjerash parasheh:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj."

Neni 32 (E drejta për mjete juridike) parasheh:

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

E drejta për një proces të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë."

Rregullorja Nr.2005/12, Për mbrojtje kundër dhunës në familje

Neni 1.2 i Rregullores nr. 2005/12 për Mbrojtje kundër dhunës në familje, e cila ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhë rasti, në pjesën përkatëse thotë:

"Dhuna në familje" do të thotë një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në një lidhje familjare si këto:

(a) Shkaktimi i lëndimit trupor"

Neni 2 i Rregullores nr. 2005/12:

"2.1 Urdhëresa për mbrojtje mund:

(a)T'ia ndalojë të pandehurit që mos të kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare."

Neni 7 i Rregullores nr. 2005/12:

"7.1 Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për mbrojtje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimit të kërkesës

7.2 Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtje, gjykata e mban seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjoj personat në vijim:

(a)pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar

(b)I pandehuri ose përfaqësuesi i autorizuar

(c)kërkuesi

(d)përfaqësuesi nga qendra për punë sociale e komunës në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:

(i)Kërkuesi është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet(18) ose i mungon aftësia juridike

(ii)Veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës madhore

7.3 Gjykata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas nenit 7.2 në bazë të ligjit për procedurën kontestimore. Nëse thirret përfaqësuesi nga qendra për punë sociale, atëherë gjykata po ashtu kërkon nga ky person që ta paraqesë mendimin e tij me shkrim, duke vlerësuar gjendjen e palës së mbrojtur."

Ligji për Familjen nr. 2004/32

Neni 137:

"(1)Kujdesi prindëror përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrat e kujdesit të përcaktuara me këtë ligj.

(2)Kujdesin prindëror e ushtrojnë prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje

(3)Nëse njëri nga prindërit ka vdekur ose është shpallur i vdekur ose nuk i është dhënë kujdesi prindëror ose i është marrë ajo, kujdesi prindëror i takon prindit tjetër.

1. *E njëjta do të aplikohet nëse për shkak të rrethanave tjera njëri prind nuk është i aftë për ushtrimin e kujdesit prindëror."*

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK)

Neni 319:

,,(1) Kryetari i trupit gjykues me urdhër cakton ditën, orën dhe vendin e shqyrtimit gjyqësor.

(2) Kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor posa aktakuza të merr formë të prerë. Nëse brenda një muaji nga forma e prerë e aktakuzës nuk caktohet shqyrtimi gjyqësor, kryetari i trupit gjykues njofton kryetarin e gjykatës për shkaqet e mos caktimit të seancës.

Kryetari i gjykatës, nëse është e nevojshme, ndërmerr masa për caktimin e shqyrtimit gjyqësor.

(3) Kur kryetari i trupit gjykues çmon se në shkresat e gjykatës ka shënime dhe informata të papranueshme, ai merr aktvendim të posaçëm për shpalljen e tyre të papranueshme. Neni 154 i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht."

Analiza

Nga analiza e bërë sipas kuptimit dhe obligimit kushtetues të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për veprimet e Gjykatës Komunale në Gjilan, lidhur me rastin, Avokati i Popullit gjen se vonesa prej katër vitesh për të shqyrtuar çështjen e parashtruar nga Prokuroria Komunale në Gjilan, përkitazi me dhunën e ushtruar ndaj ankueses, është e paarsyeshme dhe e tepruar.

Gjithashtu, *parashkrimi i ndjekjes penale dhe pushimi i procedurës penale,* ngrit shqetësime serioze për mohimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Derisa informatat në dispozicion nuk sugjerojnë se ankuesja ka kontribuar në çfarëdo zvarritje të procedurës, ndërsa ka indikacione se (mos)veprimet e gjykatës i kanë kontribuar kësaj vonese. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka gjetur se gjatë periudhës kur procedura penale kundër vjehrrit të ankueses ka qenë në pritje për t'u vendosur në gjykatën komunale në Gjilan, i njëjti gjyqtar i gjykatës ka vendosur për tri raste të tjera pa zvarritje të theksuara.

Për rastin P. nr. 619/2005 (aktakuza e ngritur më 26 maj 2005, ndërsa vendimi është marrë më 13 prill 2006).

Për rastin P. nr. 631/2005 (aktakuza e ngritur më 27 maj 2005, ndërsa është vendosur më 14 prill 2006).

Për rastin P. nr. 632/2005, (aktakuza e ngritur më 26 maj 2005, ndërsa është vendosur më 13 prill 2006).

Gjithashtu, Avokati i Popullit rikujton se, përveç vonesës për të caktuar seancat për rastin e përmendur më lart, *gjykata ka dështuar që në procedurën për besimin e fëmijës në edukim, kujdes dhe ruajtje të dëgjojë edhe mendimet e përfaqësueseve të QPS-së dhe në veçanti të përfaqësuesit ligjor, pra nënës së fëmijës.*

Privimi i të drejtës së prindërve për t'u dëgjuar dhe besimi i fëmijës për kujdes, ruajtje dhe edukim, vjehrrës së ankueses paraqet veprim të kundërligjshëm të gjykatës dhe është në kundërshtim me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, të cilin parim gjykata ka për detyrë ta shqyrtojë në çdo rast të paraqitur.

E drejta në mjete efektive: Neni 13 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut

Gjithashtu, duhet të analizohet ekzistimi i mungesës së mjeteve efektive që përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

"Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare."

Neni 13 pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare të mbrojë të drejtat e njeriut, përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garancë shtesë për një individ për të siguruar që ai apo ajo gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e Nenit 13 garantojnë një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor (*aktgjykimi në rastin Kudla kundër Polonisë*).

Kështu neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.

Avokati i Popullit vëren se edhe pse çështja është ngritur nga Institucioni i Avokatit të Popullit në të gjitha raportet e tij të mëparshme, lidhur me zvarritje të procedurës, *nuk janë ndërmarrë masa vepruese nga autoritetet publike për të zgjidhur situatën ekzistuese.*

Konkludim

Prandaj, Avokati i Popullit konkludon se *ka pasur shkelje të së drejtave dhe lirive të njeriut në rastin e znj. M. B. për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor* të garantuara me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të nenit 31 E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm dhe nenit 32, E Drejta për Mjete Juridike, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimi i mirë për përmirësimin e punës dhe rritjen e efektivitetit të gjyqësorit, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi, e vlerëson të arsyeshëm këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës së shkelur ndaj znj. M. B..

Për këtë qëllim, në pajtim me nenin 22.3 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit

R E K O M A N D O N

Kryetarit të Gjykatës Komunale në Gjilan

- që rastet lëndëve gjyqësore që kanë të bëjnë me dhunën në familje të trajtohen me prioritet dhe pa zvarritje të procedurave gjyqësoren.

Kryesuesit të Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Zyra e Prokurorit Disiplinor

- të fillojë hetimet lidhur me të gjeturat e këtij raporti në Gjykatën Komunale në Gjilan për rastin e znj. M. B. dhe të marrë masa disiplinore nëse konstaton shkeljet ligjore në dëm të ankueses.

Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor i Kosovës

- këtë raport të Avokatit të Popullit t'ua shpërndajë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale në Kosovë.

Në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195 dhe nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerreni, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimit të lartpërmendur.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj në lidhje me këtë, ta dërgoni brenda një afati ligjor prej tridhjetë (30) ditësh.

Raporti iu dërgohet:

1. Z. Enver Peci, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Z. Ramiz Azizi, kryetar i Gjykatës Komunale në Gjilan.

Me nderime,

Sami Kurteshi
Avokat i Popullit